UDHËZIM
Nr.40, datë 24.12.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhje tarifat", të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

1. Tarifat e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, është në shumën 10 euro dhe paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës.
2. Tirana International Airport (TIA), në zbatim të Marrëveshjes së koncesionit dhe këtij udhëzimi, kryen të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj tarifie shërbimi në sistmein e IATA-s. Pas këtij regjistrimi, çdo shoqëri ajrore, në momentin e shitjes së biletave, duhet t'i shtojë vlerës së biletës, si dhe ta pasqyrojë në të, edhe vlerën e kësaj tarife shërbimi.
3. Vjelja e kësaj tarife kryhet pavarësisht vendit të shitjes apo mënyrës së shitjes së biletës nga shoqëritë ajrore. Vjelja e tarifës së paguar nga udhëtarët, në momentin që ata blejnë biletën e avionit dhe që derdhet nga ana e shoqërive ajrore, duhet të reflektohet nëpërmjet faturimeve që TIA u lëshon shoqërive ajrore që operojnë në aeroportin "Nënë Tereza". Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit të pasagjerëve dhe këto dokumente ruhen në TIA dhe shoqërinë ajrore. Shumat e arkëtuara nga TIA, nëpërmjet shoqërive ajrore, derdhen brenda 5 ditëve punë në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit.
4. Mbi tarifat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.
5. Çdo muaj do të bëhet rakordimi i tarifës së mbledhur nga TIA me PKPK Rinas dhe shoqëritë ajrore.
6. Për shërbimin e kryer, TIA përfiton 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në Buxhetin e Shtetit.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi